



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Nr. 12 prot.

Kamëz, më 18.02 2019

V E N D I M

Nr. 11 . datë 18/02/2019

**MBI SHQYRTIMIN E VKB-SË NR. 145, DATË 19/12/2018 “PËR MIRATIMIN NË
PARIM TË DHËNIES ME QIRA TË DISA PRONAVE NË BASHKINË KAMËZ DHE
NJËSINË ADMINISTRATIVE PASKUQAN PËR NDËRTIMIN E TREGUT TË FRUTA-
PERIMEVE, AGROUSHQIMORE DHE VESHËMBATHJEVE”**

Këshilli Bashkiak Kamëz, i mbledhur më datë 18/02 /2019, pasi mori në shqyrtim VKB-në nr. 145 , datë 19/12 /2018, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronja “c”, nenit 18, nenit 54, shkronja “e” dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 28, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 775, datë 05.09.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi osë në përdorim të Bashkisë Kamëz”, Kreut II, të vendimit nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar, Udhëzimi nr.13, datë 26.04.2018 “Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, shkresës nr.36/3 prot., datë 15.01.2019 të Prefektit të Qarkut, nenit 16, pika 2, gërma “ii” të Ligjit 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, Këshilli Bashkiak Kamëz,

VENDOSI:

1. Të lërë në fuqi vendimin nr. 145 datë 19.12.2018 si vendim që është në përputhje me ligjin.
2. Miratimin në parim të dhënies me qira për një periudhë prej 20 (njëzet) vjet të pronave të mëposhtme:
 - “Truall”, me sipërfaqe 1380 m², me numër pasurie 129/54, zona kadastrale 2066, Kamëz në pronësi të shtetit shqiptar, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi;
 - “Truall”, me sipërfaqe 1100 m², me numër pasurie 129, zona kadastrale 2066, Kamëz në pronësi të shtetit shqiptar, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi;
 - “Truall”, me sipërfaqe 3350 m², me numër pasurie 145/2, zona kadastrale 2066, Kamëz në pronësi të shtetit shqiptar, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi;
 - “Truall”, me sipërfaqe 220 m², me numër pasurie 157, zona kadastrale 1066, Njësia Administrative Paskuqan në pronësi të shtetit shqiptar, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi;
 - “Truall”, me sipërfaqe 250 m², me numër pasurie 443, Njësia Administrative Paskuqan (Kryqëzimi midis Rrugës “Demokracia” dhe “Arben Broci”) në pronësi të shtetit shqiptar, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi;
 - “Truall”, me sipërfaqe 750 m², me numër pasurie 143, zona kadastrale 3993, Njësia Administrative Paskuqan në pronësi të shtetit shqiptar, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Pronat e mësipërme të përdoren për ndërtimin e tregut të fruta-perimeve, tregut agroushqimor dhe tregut të veshmbathjeve.
4. Procesi i dhënies me qira të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit dhe lidhja e kontratës të bëhet sipas përcaktimeve të vendimit nr. 54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.
5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, si dhe për lidhjen e kontratës së qirasë.
6. Ky vendim i dërgohet për njoftim Prefektit të Qarkut Tiranë.

Bilbil BAJRAKTARI

KRYETAR

